

No. 49833

**Republic of Korea
and
Albania**

Agreement on scientific and technological cooperation between the Government of the Republic of Korea and the Government of the Republic of Albania. Seoul, 24 May 1995

Entry into force: *18 May 2006 by notification, in accordance with article 9*

Authentic texts: *Albanian, English and Korean*

Registration with the Secretariat of the United Nations: *Republic of Korea, 6 July 2012*

**République de Corée
et
Albanie**

Accord de coopération scientifique et technologique entre le Gouvernement de la République de Corée et le Gouvernement de la République d'Albanie. Séoul, 24 mai 1995

Entrée en vigueur : *18 mai 2006 par notification, conformément à l'article 9*

Textes authentiques : *albanais, anglais et coréen*

Enregistrement auprès du Secrétariat de l'Organisation des Nations Unies : *République de Corée, 6 juillet 2012*

[ALBANIAN TEXT – TEXTE ALBANAIS]

MARREVESHJE MBI BASHKEPUNIMIN SHKENCOR DHE TEKNOLOGJIK
MIDIS QEVERISE SE REPUBLIKES SE KORESE DHE
QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Qeveria e Republikes se Korese dhe Qeveria e Republikes se Shqiperise
dhe (ketej e tutje te referuara si Palet Kontraktuese),

Duke patur parasysh marredheniet miqesore midis te dy vendeve ,
Duke dashur te zhvillojne me tej bashkepunimin shkencor dhe teknologjik ,
Kane rene dakord si me poshte:

Neni 1

Palet kontraktuese do te inkurajojne dhe zhvillojne, ne perputhje me
rregullat dhe ligjet e tyre respektive, bashkepunimin midis te dy vendeve ne
fushat e shkences dhe teknologjiser ne baze te barazise dhe leverdise
reciproke dhe do te percaktojne, me Marreveshje reciproke, fushat dhe ceshtjet
e nje bashkepunimi te tille.

Neni 2

Bashkepunimi sipas kesaj Marreveshje mund te perfshije format e
meposhtme:

- a) shkembimin e informacionit dhe publikimeve shkencore dhe
teknologjike;
- b) shkembimi i dokumentacionit shkencor dhe teknologjik;
- c) shkembimi i materialeve te ndryshme gjenetike;
- d) shkembimi i specialisteve per te fituar eksperience shkencore dhe
teknologjike ;
- e) bashkepunim ne hartimin dhe zbatimin e projekteve shkencore dhe
teknologjike me interes reciprok;
- f) pjesmarrja, sipas mundesise se cdo Pale Kontraktuese ne seminare,
konferenca dhe ne veprimtari te ndryshme te karakterit shkencor e teknologjik,
te organizuara ne te dy vendet ;
- g) cdo forme tjeter e bashkepunimit shkencor dhe teknologjik, sic mund
te pranohet ne menyre reciproke.

Neni 3

1. Palet Kontraktuese duhet te perpiqen te inkurajojne bashkepunimin shkencor dhe teknologjik, ne se eshte e nevojshme, nepermjet kontakteve direkte midis agjencive qeveritare, instituteve kerkimore, universiteteve dhe ndermarrjeve te te dy vendeve si dhe perfundimin e Marreveshjeve zbatuese midis tyre, duke caktuar hollesite dhe procedurat e veprimeve specifike te bashkepunimit brenda kuadrit te ligjeve dhe rregullave ne fuqi ne vendet e tyre respektive .

2. Rregullat e permendura ne Paragrafin 1 te ketij Neni duhet te perfsihjne afatet , kushtet dhe procedurat, qe do te ndiqen per veprimtari te vecanta bashkepunimi dhe per ceshtjet e tjera lidhur me to.

Neni 4

1. Ne menyre qe te kordinojne dhe te lehtesojne zbatimin e veprimtarive te bashkepunimit sipas kesaj Marreveshje, te dy Palet duhet te krijojne nje Komitet te Perbashket te Bashkepunimit Shkencor dhe Teknologjik (ketej e tutje do ti referohemi si " Komiteti i Perbashket ").

2. Komiteti i Perbashket duhet te perbehet nga perfaqesues te caktuar nga secila Pale Kontraktuese .

3. Komiteti i Perbashket duhet te mblidhet ne menyre alternative ne Republikën e Korese dhe ne Republikën e Shqiperise, kur eshte e nevojshme, me Marreveshje reciproke nepermjet kanaleve diplomatike per te diskutuar, rishqyrtuar dhe zbatuar me tej kete Marreveshje.

Neni 5

Palet Kontraktuese duhet te perballojne shpenzimet lidhur me veprimtarite e bashkepunimit sipas kesaj Marreveshje, ne baze te parimit te barazise dhe reciprocitetit dhe ne perputhje me perdorimin e te ardhurave.

Neni 6

1. Trajtimi i te drejtave te prones intelektuale, qe del nga veprimtarite e bashkepunimit sipas kesaj Marreveshje do te percaktohen ne rregullat per zbatim, te permendura ne Nenin 3 te kesaj Marreveshje.

2. Informacioni shkencor dhe teknologjik, i nje natyre pa pronesi, qe del nga veprimtarite e bashkepunimit duhet t'i jepet, ne se nuk vendoset ndryshe, nje pale te trete ne perputhje me procedurat e zakonshme te agjencive pjesmarrese.

Neni 7

Kjo Marreveshje nuk duhet te preke vlefshmerine apo ekzekutimin e ndonje detyrimi, qe del nga traktatet ose Marreveshjet e tjera nderkombetare e perfunduara nga secila prej Paleve Kontaktuese.

Neni 8

Autoritetet qeveritare perkatese, pergjegjese per zbatimin e kesaj Marreveshje jane: Ministria e Shkences dhe Teknologjise per Palen Koreane dhe Komiteti i Shkences dhe Teknologjise per Palen Shqiptare.

Neni 9

1. Kjo Marreveshje do te hyje ne fuqi ne daten kur Palet Kontraktuese te njoftojne njera-tjetren se jane plotesuar te gjitha kerkesat ligjore per hyrjen e saj ne fuqi . Ajo do te jete e vlefshme per nje afat prej pese vjetesh dhe do te mbetet ne fuqi dhe per pese vjet te tjera ne se asnjera prej Paleve Kontraktuese nuk e shpall te pavlefshme me shkrim, gjashte muaj para se te skadoje ky afat.

2. Perfundimi i afatit te kesaj Marreveshje nuk duhet te preke plotesimin e ndonje projekti apo programi te ndermarre ne perputhje me rregullat e zbatimit te referuara ne Nenin 3 dhe i pa realizuar plotesisht ne kohen e perfundimit te afatit te kesaj Marreveshje.

Ne prezence , nenshkruesit, te autorizuar plotesisht nga Qeverite e tyre respektive, kane nenshkruar kete Marreveshje.

Bere ne dy kopje ne Seul me 24 maj 1995 ne gjuhet koreane, shqipe dhe angleze, te gjitha tekstet te barazvlefshem. Ne rast te ndonje keqkuptimi ne interpretim, teksti ne gjuhen angleze do te merret per baze.

PER QEVERINE E
REPUBLIKES SE KORESE



PER QEVERINE E
REPUBLIKES SE SHQIPERISE



[ENGLISH TEXT – TEXTE ANGLAIS]

AGREEMENT ON SCIENTIFIC AND TECHNOLOGICAL COOPERATION
BETWEEN THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF KOREA
AND THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF ALBANIA